



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
USTAVNI SUD
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 5 gusht 2024
Nr. Ref.: RK 2497/24

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI16/24

Parashtrues

Isa Baçaj

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit E.Rev.nr.306/2023 të 17 gushtit
2023 të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar
Enver Peci, gjyqtar dhe
Jeton Bytyqi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga Isa Baçaj nga Gjakova, i përfaqësuar nga Teki Bokshi, avokat në Komunën e Gjakovës (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston kushtetutshmërinë e Aktgjykimit [E.Rev.nr.306/2023] të 17 gushtit 2023, të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata Supreme), në lidhje me Aktgjykimin [Ac.nr.4613/2018] të 29 marsit 2023, të Gjykatës së Apelit të Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata e Apelit), si dhe në lidhje me Aktgjykimin [C.nr.121/13] të 2 korrikut 2018, të Gjykatës Themelore në Gjakovë – Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil (në tekstin e mëtejme: Gjykata Themelore).
3. Parashtruesi i kërkesës e kishte pranuar vendimin e kontestuar më 18 shtator 2023.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimit të kontestuar, me të cilat pretendohet se parashtruesit të kërkesës i janë shkelur të drejtat e garantuara me nenin 24 [Barazia para Ligjit], nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ), si dhe nenin 1 (Mbrojtja e Pronës) të Protokollit 1 të KEDNJ-së.

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në paragrafin 1 dhe 7 nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, nenet 22 (Procedimi i kërkesës), 27 (Masat e përkohshme) dhe 47 (Kërkesa individuale) të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 25 (Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve) dhe 44 (Kërkesa për masë të përkohshme) të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 18 janar 2024, parashtruesi i kërkesës dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
7. Më 25 janar 2024, Kryetarja e Gjykatës përmes vendimit [Nr. GJR. KI16/24] caktoi gjyqtarin Radomir Laban, gjyqtar raportues dhe me vendimin [nr. KSH. KI16/24] caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Gresa Caka-Nimani (kryesuese), Bajram Ljatifi (anëtar) dhe Safet Hoxha (anëtar).
8. Më 13 shkurt 2024, Gjykata e informoi parashtruesin e kërkesës për regjistrimin e kërkesës dhe në të njëjtën ditë i dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës Supreme.
9. Më 13 shkurt 2024, Gjykata kërkoi nga Gjykata Themelore që të dorëzojë fletëkthesën e cila dëshmon datën e pranimit të vendimit nga ana e parashtruesit të kërkesës.
10. Më 23 shkurt 2024, Gjykata Themelore dorëzoi fletëkthesën në Gjykatës, sipas së cilës konfirmohet që parashtruesi i kërkesës e kishte pranuar vendimin e kontestuar më 18 shtator 2023.
11. Më 11 mars 2024, gjyqtari Jeton Bytyqi dha betimin para Presidentes së Republikës së Kosovës, me ç' rast filloi mandati i tij në Gjykatë.

12. Më 16 korrik 2024, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhje e fakteve

13. Nga shkresat e lëndës rezultoi që parashtruesi i kërkesës parashtrroi padi për vërtetimin e pronësisë kundër të paditurve [(i) Komuna e Gjakovës, (ii) Republika e Kosovës dhe (iii) A. Z., duke theksuar se në bazë të parakontratës së 15 majit 2006, parashtruesi i kërkesës nga pala e tretë A.Z. kishte blerë paluajtshmërinë e cila gjendet në Gjakovë, në sipërfaqe prej 350 m². Parashtruesi i kërkesës paluajtshmërinë e lartcekur e kishte blerë nga A.Z., duke u bazuar në Aktgjykimin e Gjykatës Komunale [C.nr. 121/16] të 10 prillit 2006 i plotfuqishëm me datën 10 maj 2006, i cili ka qenë i furnizuar edhe me klauzolën të formës së prerë.
14. Parashtruesi i kërkesës duke u bazuar në Aktgjykimin e lartcekur kishte investuar në paluajtshmërinë e lartcekur dhe kishte ndërtuar shtëpinë e banimit me vlerë më të madhe se vlera e tokës ndërtimore. Parashtruesi i kërkesës kishte hasur në vështirësi në regjistrimin në Zyrën Kadastrale në Gjakovë, pasi që e njëjta kishte theksuar se në Aktgjykimin e lartcekur vetëm ceket vendi i quajtur "*potesi Llukac*", në sipërfaqe prej 350 m², zona Kadastrale Gjakovë – qytet, por jo edhe numri i njësisë. Rrjedhimisht, parashtruesi i kërkesës dorëzoi padi për vërtetim të pronës në paluajtshmërinë dhe objektin ndërtimor ndërtuar në të.
15. Më 2 korrik 2018, Gjykata Themelore përmes Aktgjykimit [C.nr.121/13]: (I) refuzoi si të pabazuar kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës me të cilën kërkonte që të vërtetohet se është pronar i pjesës së paluajtshmerisë e cila evidentohet në librat kadastral si ngastër kadastrale [nr. 5718-1] me kulturë ujëra publike ZK Gjakovë jashtë qytetit dhe atë i pjesës e cila gjendet në kufi me ngastrat kadastrale [4396/1] dhe [4396/2] e cila pjesë në anën lindore ka gjatësinë prej 32,96 m² + 3,68 m², në kufi me ngastrat e cekura më parë [4396/1], [4396/2] e cila pjesë në anën lindore ka gjatësi prej 14.21 m², e cila kufizohet me pjesën tjetër të ngastrës kadastrale [5718-1] në anën perëndimore në gjatësi prej 5,82 m + 3.13 + 27.35 në të cilën pjesë po ashtu kufizohet me ngastrën e cekur [5718/1] si dhe në pjesën jugore në gjatësi prej 8.45 + 4.25 dhe atë me kulturë shtëpi në sipërfaqe prej 162 m² dhe me kulturë oborr 357 m², përkatësisht në sipërfaqe të përgjithshme prej 519 m² të gjitha ZK Gjakovë jashtë qytetit, përkatësisht në pozitë dhe përmasa siç është përcaktuar me ekspertizën gjeodezike të ekspertëve B. M. dhe G.B. të 12 prillit 2018, duke e detyruar të paditurën e dytë Republika e Kosovës -Qeveria e Kosovës - Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe të paditurin e tretë A. Z. nga fshati Shqiponjë, Komuna e Gjakovës, që parashtruesit të kërkesës të ia pranojnë këtë të drejtë, në afat prej 15 dite kur ky Aktgjykim të merr formën e prerë, nën kërcënim të përmbarrimit; (II) miratohet tërheqja e padisë së parashtruesit të kërkesës e parashtruar kundër të paditurës së parë Komuna e Gjakovës, për vërtetimin e pronësisë në kuptim të nenit 261.2 të LPK-së; (III) Secila palë i bartë shpenzimet e veta.
16. Kundër këtij aktgjykimi parashtruesi i kërkesës në afat ligjor paraqiti ankesë për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave procedurale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit, ta ndryshoj aktgjykimin e goditur ashtu që kërkesëpadia e parashtruesit të kërkesës të aprovohet në tërësi si e bazuar, apo aktgjykimin e atakuar ta prishë dhe çështja ti kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe rivendosje.
17. Në anën tjetër, brenda afatit ligjor kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë ankesë paraqiti i padituri A. Z. për shkak të shkeljeve të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale me propozimin që Gjykata e Apelit të aprovojë

si të bazuar ankesën parashtruesit të kërkesës, kurse kërkesëpadinë e parashtruesit ta aprovojë në tërësi si të bazuar.

18. Përgjigje në ankesat e parashtruesit të kërkesës dhe të paditurit A. Z. ka paraqitur Avokatura Publike e Komunës së Gjakovës, UD. V. Sh., me propozim që ankesat e parashtruesit të kërkesës dhe e të paditurit A. Z. të refuzohen si të pabazuara, kurse aktgjykimin e atakuar ta vërtetojë.
19. Më 29 mars 2023, Gjykata e Apelit përmes Aktgjykimit [Ac.nr. 4613/2018] refuzoi si të pabazuara ankesat e parashtruesit të kërkesës dhe të paditurit A. Z. nga fshati Shqiponjë, Komuna e Gjakovës, ndërsa vërtetoi Aktgjykimin [C.nr.121/13] e 2 korrikut 2018, e Gjykatës Themelore. Në arsyetimin e Aktgjykimit të saj Gjykata e Apelit theksoi si në vijim:

Gjykata e Apelit mbështet arsyetimin e vendimit të gjykatës së shkallës së parë lidhur me bartjen e të drejtës së pronësisë duke ua kujtuar palëve ndërgjyqëse nenin 36 të LPDTS-së e cila shprehimisht përcakton "1. Për bartjen e pronësisë në paluajtshmëri është e nevojshme një punë juridike e vlefshme ndërmjet tjetërsuesit dhe fituesit si bazë juridike dhe regjistrimi i ndryshimit i pronësisë në regjistrin e të drejtave në paluajtshmëri. 2. Kontrata për bartjen e paluajtshmërisë duhet të lidhet me shkrim në prezencë të dy palëve në një zyre kompetente."

Në kuptim të dispozitave të lartcekura për bartjen e pronësisë duhet plotësuar disa kushte si a) Puna juridike (ius titulus), b) Regjistrimi i ndryshimit të pronësisë në regjistrin e të drejtave në paluajtshmëri dhe e) Puna juridike të lidhet në një zyre kompetente në prezencë të dy palëve. Parakontrata e lidhur ndërmjet palëve ndërgjyqëse këtu paditësit Isa Bacaj dhe A. Z. nuk paraqet titull juridik mbi bazën e të cilit do mund të bartej e drejta e pronësisë për arsyen se e njëjta nuk është lidhur në zyrën kompetente ashtu siç kërkohet nga ligji dhe nga fakti se bazuar në aktgjykimin e gjykatës komunale në Gjakovë i padituri A. Z. nuk ka fituar të drejtën e pronësisë, por ka fituar vetëm të drejtën e shfrytëzimit të përhershëm e që në këtë pikë qëndron edhe arsyetimi i gjykatës së shkallës së parë përkatësisht "Nemo plus iuris ad alium trans/ere quam ipse haberet" askush nuk mund të tjetërsojë në tjetrin më shumë të drejta se sa që ka vetë.

20. Parashtruesi i kërkesës paraqiti kërkesë për revizion kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë, për shkak të: (i) shkeljes thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe (ii) zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovohet revizioni duke e ndryshuar aktgjykimin e Gjykatës së Apelit dhe atë të Gjykatës Themelore, duke aprovuar në tërësi padinë e parashtruesit të kërkesës, apo që të prish aktgjykimin e gjykatës së shkallës së dytë, të aprovoje ankesën dhe çështjen t'ia kthejë gjykatës së shkallës së parë në rigjykim e rivendosje.
21. Më 17 gusht 2023, Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit [Rev.nr. 306/2023] refuzoi si të pathemeltë revizionin e parashtruesit të kërkesës të paraqitur kundër Aktgjykimit [Ac.nr. 4613/2018] të 29 marsit 2023, të Gjykatës së Apelit të Kosovës.

"Kështu, sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, nga provat e administruara, nuk mund të përfundohet se paditësi është pronar i pjesës së paluajtshmërisë kontestuese, të specifikuar në dispozitiv të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, nga se me asnjë bazë juridike nuk ka provuar pronësinë në pjesën e paluajtshmërisë kontestuese, për të cilën ka kërkuar që të vërtetohet se është pronar, sikundër parashihet me dispozitën e nenit 20 të Ligjit për Marrëdhëniet Themelore Pronësore Juridike, sipas së cilës, është paraparë se e drejta e pronësisë fitohet sipas vet ligjit, në bazë të veprimtimit juridik (punës juridike), dhe me trashëgimi

apo me vendim të organit shtetëror në mënyrën dhe nen kushtet e përcaktuara me ligj.

[...] në rastin konkret civil - juridik, paditësi nuk e ka provuar as bazën juridike e as mënyrën e fitimit (iustus titullus - modus aquirendi) të pronësisë në pjesën e paluajtshmërisë kontestuese, të sipër përmendur. Përkitazi me këtë që u sipër theksua, paditësi nuk ka provuar se e ka fituar pronësinë në kuptim të dispozitës së nenit 20 apo nenit 33 të LMTHPJ-së dhe as në bazë të parashkrimit fitues (Usucapio - neni 28 i LMTHPJ-së), përkatësisht, se me posedim dhe me mirëbesim e ka fituar pronësinë në paluajtshmërinë kontestuese.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

22. Parashtruesi i kërkesës pretendon se nëpërmjet Aktgjykimit [E.Rev.nr.306/2023] të 17 gushtit 2023, të Gjykatës Supreme, i janë shkelur të drejtat e garantuara me nenin 24 [Barazia para Ligjit], nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së dhe nenin 1 (Mbrojtja e Pronës) të Protokollit 1 të KEDNJ-së.
23. Fillimisht, parashtruesi i kërkesës pretendon se është aplikuar gabimisht nga gjykatat e rregullta Ligji nr. 03/L-154 për pronësinë dhe të drejtat tjera sendore, pasi që i njëjti ka hyrë në fuqi me 20 gusht 2009 dhe se nuk ka efekt prapaveprues. Ndërsa sipas parashtruesit, raporti i tij juridik kishte përfunduar para datës 20 gusht 2009. Prandaj i njëjti thekson se në rastin e tij aplikohet Ligji për bazat e marrëdhënieve pronësore juridike - Gazeta zyrtare e RSFJ nr.6/1980. Në këtë kontekst, i njëjti pretendon se i është shkelur neni 31 dhe 46 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së, si dhe neni 1 i Protokollit shtesë të KEDNJ-së, pasi që parashtruesi i kërkesës si suksesor i të drejtave të të paditurit A. Z. është privuar nga e drejta në pronë.
24. Në ndërlidhje me shkeljen e të drejtës për gjykim të drejtë, parashtruesi i kërkesës konsideron se vendimet e gjykatave të jurisdiksionit të rregullt janë të pa arsyeuara, në kontekst të aplikimit të gabuar të së drejtës materiale në dëm të parashtruesit të kërkesës.
25. Në vijim, parashtruesi i kërkesës gjithashtu pretendon se “në një çështje juridike relativisht të ngjashme, në shkallë të parë e gjykuar nga e njëjta gjykatë, është vendosur ndryshe, ku qytetarit i janë mbrojtur të drejtat njerëzore dhe lirive themelore. Shembuj te praktikes juridike janë bashkëngjitur ankesës ndaj Aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë. Aplikimi në mënyra të ndryshme i ligjit për qytetarë të ndryshëm paraqet shkelje të parimit të barazisë para ligjit, e cila e drejtë është e garantuar me nenin 24 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.”
26. Përfundimisht, parashtruesi i kërkesës kërkon nga gjykata që: i. të deklarojë kërkesën e pranueshme; ii. të konstatoj që aktgjykimi i gjykatës supreme [rev.nr.306/2023] i 17 gushtit 2023 nuk është në përputhje me nenin 31 të kushtetutës dhe lidhur me nenin 6 të KEDNJ-së dhe nuk është në përputhje me nenin 46 të kushtetutës, në lidhmëni me nenin 1 të protokollit 1 të KEDNJ-së; iii. të shpallë, të pavlefshëm aktgjykimin e gjykatës supreme [Rev. nr. 306/2023] të 17 gushtit 2023; iv. t'ua kumtojë këtë aktgjykim palëve, v. të shpallë aktgjykimin në Gazetën Zyrtare, në pajtim me paragrafin 5 të nenit 20 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese.

Dispozitat relevante kushtetuese

KUSHTETUTA E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Neni 24 [Barazia para Ligjit]

1. Të gjithë janë të barabartë para ligjit. Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes së barabartë ligjore, pa diskriminim.

2. Askush nuk mund të diskriminohet në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimeve politike ose të tjera, prejardhjes kombëtare a shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronës, gjendjes ekonomike, sociale, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal.

3. Parimet e mbrojtjes së barabartë ligjore nuk parandalojnë vënien e masave të nevojshme për mbrojtjen dhe përparimin e të drejtave të individëve dhe grupeve që janë në pozitë të pabarabartë. Masat e tilla do të zbatohen vetëm derisa të arrihet qëllimi për të cilin janë vënë ato.

Neni 31

[E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

1. "Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.

2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj."

[...]

6. Ndihma juridike falas do t'u mundësohet atyre që nuk kanë mjete të mjaftueshme financiare, nëse një ndihmë e tillë është e domosdoshme për të siguruar qasjen efektive në drejtësi."

[...]

Neni 46 [Mbrojtja e Pronës]

1. E drejta e pronës është e garantuar.

2. Shfrytëzimi i pronës rregullohet me ligj, në pajtim me interesin publik.

3. Askush nuk do të privohet në mënyrë arbitrare nga prona. Republika e Kosovës ose autoriteti publik i Republikës së Kosovës mund të bëjë ekspropriimin e pronës nëse ky eksproprijim është i autorizuar me ligj, është i nevojshëm ose i përshtatshëm për arritjen e qëllimit publik ose përkrahjen e interesit publik, dhe pasohet me sigurimin e kompensimit të menjëhershëm dhe adekuat për personin ose personat prona e të cilave ekspropriohehet.

4. Kontestet që lindin nga akti i Republikës së Kosovës ose autoritetit publik të Republikës së Kosovës për të cilat pretendohet se përbëjnë ekspropriimin, do të zgjidhen nga gjykata kompetente.

5. Prona intelektuale mbrohet me ligj.

KONVENTA EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT

Neni 6

(E drejta për një proces të rregullt)

1. *“Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e gjykatës mund t’i ndalohet shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohet nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtonte interesat e drejtësisë.*
2. *Çdo person i akuzuar për një vepër penale prezumohet i pafajshëm, derisa fajësia e tij të provohet ligjërisht.*
3. *Çdo i akuzuar për një vepër penale ka të drejtat minimale të mëposhtme:*
 - a) *të informohet brenda një afati sa më të shkurtër, në një gjuhë që ai e kupton dhe në mënyrë të hollësishme, për natyrën dhe për shkakun e akuzës që ngrihet ndaj tij;*
 - b) *t’i jepet koha dhe lehtësitë e përshtatshme për përgatitjen e mbrojtjes;*
 - c) *të mbrohet vetë ose të ndihmohet nga një mbrojtës i zgjedhur prej tij, ose në qoftë se ai nuk ka mjete të mjaftueshme për të shpërblyer mbrojtësin, t’i mundësohet ndihma ligjore falas kur këtë e kërkojnë interesat e drejtësisë;*
 - d) *të pyesë ose të kërkojë që të merren në pyetje dëshmitarët e akuzës dhe të ketë të drejtën e thirrjes dhe të pyetjes të dëshmitarëve në favor të tij, në kushte të njëjta me dëshmitarët e akuzës; e. të ndihmohet falas nga një përkthyes në qoftë se nuk kupton ose nuk flet gjuhën e përdorur në gjyq.”*

LIGJ MBI MARRËDHËNIET THEMELORE JURIDIKE PRONËSORE

Fitimi i së drejtës së pronësisë

Neni 20

E drejta e pronësisë fitohet sipas vetë ligjit, në bazë të veprimit juridik dhe me trashëgim.

E drejta e pronësisë fitohet edhe në bazë të vendimit të organit shtetëror në kushtet dhe në mënyrën e caktuar me ligj.

Neni 28

Mbajtësi me mirëbesim dhe i ligjshëm i sendit të luajtshëm, mbi të cilin tjetri ka të drejtën e pronësisë, fiton të drejtën e pronësisë mbi këtë send me parashkrimin fituese me kalimin e kohës prej tre vjetësh.

Mbajtësi me mirëbesim dhe i ligjshëm i sendit të paluajtshëm, mbi të cilin tjetri ka të drejtën e pronësisë fiton të drejtën e pronësisë mbi këtë send me parashkrimin fitues me kalimin e kohës prej dhjetë vjetësh.

Mbajtësi me mirëbesim i sendit të luajtshëm, mbi të cilin tjetri ka të drejtën e pronësisë, fiton të drejtën e pronësisë mbi këtë send me parashkrimin fitues me kalimin e kohës prej dhjetë vjetësh.

Mbajtësi me mirëbesim i sendit të paluajtshëm, mbi të cilin tjetri ka të drejtën e pronësisë, fiton të drejtën e pronësisë mbi këtë send me parashkrimin fitues me kalimin e kohës prej 20 vjetësh.

Trashëgimtari bëhet mbajtës me mirëbesim nga momenti i hapjes së trashëgimisë edhe në rastin kur trashëgimlënësi ka qenë mbajtës me keqbesim, e trashëgimtari këtë nuk e ko ditur as që ka mundur ta dinte kurse koha për parashkrimin fitues fillon të ece nga momenti i hapjes së trashëgimisë.

Neni 33

Në bazë të veprimit juridik e drejta e pronësisë mbi pasurinë e paluajtshme fitohet me regjistrimin në librin publik ose në mënyrën tjetër përkatëse të caktuar me ligj.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

27. Gjykata së pari shqyrton nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të cilat janë të përcaktuara me Kushtetutë, të parashikuara me Ligj dhe të specifikuara më tej me Rregullore të Punës.
28. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës që përcaktojnë:

Neni 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara]

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

[...]

29. Në vazhdim, Gjykata gjithashtu shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, siç përcaktohen me Ligj. Në lidhje me këtë, Gjykata së pari i referohet neneve 47 (Kërkesa individuale), 48 (Saktësimi i kërkesës) dhe 49 (Afatet) të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47 (Kërkesa individuale)

“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individ i mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

Neni 48
(Saktësimi i kërkesës)

“Parashtruesja e kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestojë”.

Neni 49
(Afatet)

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajsh. Afati fillon të ecë nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor...”.

30. Sa i përket përmbushjes së këtyre kritereve, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar, që konteston një akt të një autoriteti publik, përkatësisht Aktgjykimin [E. Rev. 306/2023] të 17 gushtit 2022, të Gjykatës Supreme, pasi i ka shteruar të gjitha mjetet juridike të parapara me ligj. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu i ka qartësuar të drejtat dhe liritë që pretendon se i janë shkelur në pajtim me kërkesat e nenit 48 të Ligjit dhe e ka dorëzuar kërkesën në pajtim me afatin e përcaktuar në nenin 49 të Ligjit.
31. Përveç kësaj, Gjykata gjithashtu shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në rregullin 34 [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores së punës. Rregulli 34 (2) i Rregullores së punës përcakton që:
- “Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, kur parashtruesi/ja nuk dëshmon dhe nuk mbështet në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij/saj.”*
32. Gjykata, fillimisht thekson që rregulli i lartcekur, bazuar në praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: GJEDNJ) dhe të Gjykatës, i mundëson kësaj të fundit, që të shpallë kërkesa të papranueshme për arsye që ndërlidhen me meritat e një rasti. Më saktësisht, bazuar në këtë rregull, Gjykata mund të shpallë një kërkesë të papranueshme bazuar në dhe pas vlerësimit të meritave të saj, përkatësisht nëse e njëjta vlerëson se përmbajta e kërkesës është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, siç është përcaktuar në paragrafin (2) të rregullit 34 të Rregullores së punës.
33. Bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së por edhe të Gjykatës, një kërkesë mund të shpallet e papranueshme si “qartazi e pabazuar” në tërësinë e saj ose vetëm përkitazi me ndonjë pretendim specifik që një kërkesë mund të ngërthejë. Në këtë drejtim, është më e saktë t’iu referohet të njëjtave si “pretendime qartazi të pabazuara”. Këto të fundit, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, mund të kategorizohen në katër grupe të veçanta: (i) pretendime që kualifikohen si pretendime “të shkallës së katërt”; (ii) pretendime që kategorizohen me një “mungesë të dukshme ose evidente të shkeljes”; (iii) pretendime “të pambështetura apo të paarsyetuara”; dhe në fund, (iv) pretendime “konfuze dhe të paqarta” (shih, rastet e GjEDNJ-së, [Kemmachev kundër Francës, Kërkesa nr. 17621/91](#), kategoria (i), [Mentzen kundër Letonia, Kërkesa nr. 71074/01](#), kategoria (ii) dhe [Trofimchuk kundër Ukrainës, Kërkesa nr. 4241/03](#), kategoria (iii); shih gjithashtu rastet e Gjykatës: [KI40/20](#), parashtrues *Sadik Gashi*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 20 janarit 2021; [KI163/18](#), parashtrues *Kujtim Lleshi*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 24 qershorit 2020; [KI21/21](#), parashtrues, *Asllan Meka*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 28 prillit 2021, [KI107/21](#), parashtrues *Ramiz Hoti*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 21 tetorit 2021).

34. Në kontekst të vlerësimit të pranueshmërisë së kërkesës, përkatësisht, në vlerësimin nëse e njëjta është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, Gjykata fillimisht do të rikujtojë esencën e rastit që ngërthen kjo kërkesë dhe pretendimet përkatëse të parashtruesit të kërkesës, në vlerësimin e të cilave, Gjykata do të aplikojë standardet e praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, në harmoni me të cilën, në bazë të nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, ajo është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë.
35. Kësisoj, Gjykata fillimisht rikujton që rrethanat e rastit ndërlidhen me kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës për vërtetimin e të drejtës së pronësisë, pasi që më 15 maj 2006, përmes parakontratës kishte blerë një paluajtshmëri nga pala e interesuar A.Z. në komunën e Gjakovës, të cilën nuk e kishte regjistruar në librat e tokës konform procedurës ligjore. Pas refuzimit të kërkesëpadisë së parashtruesit të kërkesës nga Gjykata Themelore, i njëjti parashtron ankesë të cilën gjithashtu e refuzon Gjykata e Apelit. Përfundimisht, edhe kërkesën për revizion të parashtruesit të kërkesës e refuzoi Gjykata Supreme e cila e theksoi se i njëjti nuk ka provuar përmes asnjë baze juridike pronësinë në paluajtshmërinë kontestuese sikundër parashihet me nenin 20 dhe 38 të Ligjit për Marrëdhëniet Themelore Pronësore Juridike.
36. Në këtë drejtim, Gjykata rikujton që parashtruesi i kërkesës i konteston konstatimet e gjykatave të rregullta para Gjykatës, duke pretenduar: (I) shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, si rezultat i *mungesës së arsytimit të vendimit gjyqësor*, për sa i përket zbatimit të gabuar të së drejtës materiale; (II) pretendime për shkelje të nenit 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës, përkatësisht cenim të të drejtave pronësore si rezultat i pamundësisë të realizimit të kërkesëpadisë së tij lidhur me vërtetimin e të drejtës së pronës, si dhe (III) pretendimit për shkelje të nenit 24 [Barazia para Ligjit] si rezultat i asaj se në një çështje juridike relativisht të ngjashme, në shkallë të parë e gjykuar nga e njëjta gjykatë, është vendosur ndryshe, ku qytetarit i janë mbrojtur të drejtat njerëzore dhe lirive themelore.
37. Në këtë aspekt, Gjykata fillimisht thekson se e drejta për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm e garantuar me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së dhe zbatimi i saj, është interpretuar gjerësisht nga GJEDNJ përmes praktikës së saj gjyqësore. Rrjedhimisht, sa i përket interpretimit të pretendimeve për shkeljen e së drejtës në gjykim të drejtë dhe të paanshëm si rezultat i "*mos arsytimit të vendimit gjyqësor*", Gjykata do t'i referohet praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së; dhe me pas, do t'i aplikojë të njëjtat në rrethanat e rastit konkret. Ndërsa më pas do ti trajtojë pretendimet e parashtrueses së kërkesës lidhur me shkeljen e të drejtës në pronë, si dhe pretendimet për shkelje të nenit 24 të Kushtetutës.

I. Vlerësimi i Gjykatës përkitazi me pretendimet për shkelje të së drejtës për "*vendim të arsytuar*"

a) Parimet e përgjithshme

38. Garancitë e përcaktuara në nenin 6 paragrafi 1 përfshijnë edhe detyrimin që gjykatat të japin arsye të mjaftueshme për vendimet e tyre (shih rastin e GJEDNJ-së, [H. kundër Belgjikës](#), nr. 8950/80, Aktgjykim i 30 nëntorit 1987, paragrafi 53). Një vendim i arsytuar u tregon palëve se çështja e tyre është dëgjuar me të vërtetë.
39. Përkundër faktit që gjykata e brendshme ka një liri të caktuar të vlerësimit lidhur me përzgjedhjen e argumenteve dhe vendosjes për pranueshmërinë e dëshmimeve, ajo është e detyruar të justifikojë veprimet e saj duke arsytuar të gjitha vendimet e saj (shih rastet e GJEDNJ-së [Suominen kundër Finlandës](#), nr. 37801/97, Aktgjykim i 24 korrikut 2003,

paragrafi 36; si dhe aktgjykimin [Carmel Saliba kundër Maltës](#), nr. 24221/13, Aktgjykim i 24 prillit 2017, paragrafi 73).

40. Gjykata më e ulët ose autoriteti shtetëror, nga ana tjetër, duhet të japin arsye dhe arsyetime të tilla të cilat do t'u mundësojnë palëve të shfrytëzojnë në mënyrë efektive çdo të drejtë ekzistuese të ankesës (shih rastin e GJEDNJ-së [Hirvisaari kundër Finlandës](#), nr. 49684/99, Aktgjykim i 25 dhjetorit 2001, paragrafi 30).
41. Neni 6, paragrafi 1 i detyron gjykatat të japin arsye për vendimet e tyre, por kjo nuk do të thotë se kërkohet përgjigje e detajuar lidhur me secilin argument (shih rastin e GJEDNJ-së [Van de Hurk kundër Holandës](#), nr. 16034/90, Aktgjykim i 19 prillit 1994, paragrafi 61; [García Ruiz kundër Spanjës](#), nr. 0544/96, Aktgjykim i 29 janarit 1990, paragrafi 26; [Perez kundër Francës](#), nr. 47287/99, Aktgjykim i 12 shkurtit 2004, paragrafi 81).
42. Nga natyra e vendimit që merr gjykata varet nëse Gjkata është e detyruar ta arsyetojë atë, dhe kjo mund të vendoset vetëm në dritën e rrethanave të rastit në fjalë: është e nevojshme të merren parasysh, ndër të tjera, llojet e ndryshme të parashtresave që një palë mund t'i paraqesë gjykatës, si dhe dallimet që ekzistojnë mes sistemeve juridike të vendeve në lidhje me dispozitat ligjore, rregullat zakonore, pozicionet juridike dhe paraqitjen dhe hartimin e aktgjytimeve (shih rastet e GJEDNJ-së [Ruiz Torija kundër Spanjës](#), nr. 18390/91, Aktgjykim i 9 dhjetorit 1994, paragrafi 29; [Hiro Balani kundër Spanjës](#), nr. 18064/91, Aktgjykim i 9 dhjetorit 1994, paragrafi 27).
43. Megjithatë, nëse parashtresa e një pale është vendimtare për rezultatin e procedurës, ajo kërkon që t'i përgjigjet në mënyrë specifike dhe pa vonesë (shih rastet e GJEDNJ-së [Ruiz Torija kundër Spanjës](#), të cituar më lart, paragrafi 30; [Hiro Balani kundër Spanjës](#), të cituar më lart, paragrafi 28).
44. Prandaj, gjykatat janë të obliguara që:
 - (a) të shqyrtojnë argumentet kryesore të palëve (shih rastet e GJEDNJ-së, [Buzescu kundër Rumanisë](#), Aktgjykim i 24 gushtit 2005, nr. 61302/00, paragrafi 67; [Donadze kundër Gjeorgjisë](#), nr. 74644/01, Aktgjykim i 7 qershorit 2006, paragrafi 35);
 - (b) të shqyrtohen me shumë rigorozitet dhe kujdes të veçantë kërkesat në lidhje me të drejtat dhe liritë e garantuara me Kushtetutë, KEDNJ dhe Protokollat e saj (shih rastet e GJEDNJ-së: [Fabris kundër Francës](#), të cituar më lart, paragrafi 72; [Wagner dhe JMWL kundër Luksemburgut](#), nr. 76240/01, Aktgjykim i 28 qershorit 2007, paragrafi 96).
45. Neni 6, paragrafi 1 nuk kërkon që Gjkata Supreme të japë një arsyetim më të detajuar kur ajo thjesht zbaton një dispozitë të caktuar ligjore lidhur me bazën ligjore për refuzimin e ankesës sepse ajo ankesë nuk ka një perspektivë për sukses (shih rastet e GJEDNJ-së [Burg dhe të tjerët kundër Francës](#), nr. 34763/02, Vendim i 28 janarit 2003; [Gorou kundër Greqisë](#) (nr. 2), nr. 12686/03, Vendim i 20 marsit 2009, paragrafi 41).
46. Përveç kësaj, kur refuzon një ankesë, gjykata e apelit, në parim, thjesht mund të pranojë arsyetimin e vendimit të dhënë nga gjykata më e ulët (shih rastin e GJEDNJ-së [García Ruiz kundër Spanjës](#), të cituar më lart, paragrafi 26; shih në kundërshtim me këtë [Tatishvili kundër Rusisë](#), nr. 1509/02, Aktgjykim i 9 korrikut 2007, paragrafi 62). Megjithatë, koncepti i procedurës së drejtë nënkupton që gjykata vendase që ka dhënë një shpjegim të ngushtë për vendimet e saj, qoftë duke përsëritur arsyetimet e dhëna më parë nga një gjykatë më e ulët ose në ndonjë mënyrë tjetër, në fakt merret me çështje të rëndësishme brenda juridiksionit të saj, që do të thotë se nuk i pranoi thjesht dhe pa

përpjekje shtesë konkluzionet e arritura nga gjykata më e ulët (shih rastin e GJEDNJ-së [Helle kundër Finlandës](#), nr. (157/1996/776/977), Aktgjykim i 19 dhjetorit 1997, paragrafi 60). Kjo kërkesë është aq më tepër e rëndësishme nëse pala në kontest nuk ka pasur mundësi t'i paraqesë argumentet e saj gojarisht në procedurën para gjykatës vendase.

47. Megjithatë, gjykatat e apelit (në shkallën e dytë), të cilat kanë juridiksion për të hedhur poshtë ankesat e pabazuara dhe për të zgjidhur çështjet faktike dhe juridike në procedurën kontestimore, janë të obliguara të arsyetojnë se përse refuzuan të vendosin për ankesën (shih rastin e GJEDNJ-së [Hansen kundër Norvegjisë](#), nr. 15319/09, Aktgjykim i 2 janarit 2015, paragrafët 77–83).
48. Përveç kësaj, GJEDNJ nuk përcaktoi se ishte shkelur e drejta në një rast në të cilin nuk është dhënë një sqarim specifik në lidhje me një pohim që i referohej një aspekti të parëndësishëm të rastit, përkatësisht mungesës së nënshkrimit dhe vulës, që është një gabim i një natyre më shumë formale sesa materiale dhe ai gabim u korigjua menjëherë (shih rastin e GJEDNJ-së [Mugoša kundër Malit të Zi](#), nr. 76522/12, Aktgjykim i 21 shtatorit 2016, paragrafi 63).

b) Aplikimi i parimeve të lartcekura në rrethanat e rastit konkret

49. Referuar pretendimeve të ngritura në kërkesë, Gjykata rikujton se pretendimi kryesor i parashtruesit të kërkesës ndërlidhet me mungesën e arsytimit të aktgjykimeve të gjykatave të rregullta. Kështu, parashtruesi i kërkesës theksonte se ishte zbatuar gabimisht e drejta materiale, ku ndër të tjera pretendon se ishte zbatuar Ligji nr. 03/L-154 për pronësinë dhe të drejtat tjera sendore, ndërsa do të duhej të zbatohej Ligji për bazat e marrëdhënieve pronësore juridike.
50. Në ndërlidhje me çështjen e lartcekur, Gjykata në vazhdim do t'u referohet pjesëve relevante të aktgjykimeve të gjykatave të rregullta, që adresojnë pretendimet e parashtruesit të kërkesës. Fillimisht, Gjykata i referohet pjesëve relevante të Aktgjykimit [C.nr. 121/13] të 2 gushtit 2018, të Gjykatës Themelore, e cila arsyetoi:

“Te mënyra origjinere pronësia fitohet në bazë të Ligjit siç është parashikuar në dispozitën e nenit 21 të Ligjit mbi Marrëdhëniet Themelore Juridiko Pronësore. Pra, shitësi A. Z. (i padituri i tretë) në asnjë mënyrë dhe asnjë rrethanë nuk është titullar i së drejtës lëndore apo regjistruar pronar i paluajtshmërisë lëndore pasi që aktgjykimi C.nr.121/06 edhe pse i plotfuqishëm nuk ka hyrë në jetë për shkak të metave të paraqitura në të, ku nuk është kërkuar korigjimi apo plotësimi i tij sipas dispozitave ligjore në fuqi, ndaj lirisht mund të themi si i padituri i tretë një të drejtë të këtillë nuk e kishte as vet. Po ashtu kjo Gjykatë nuk e mori për bazë para kontratën të lidhur në mes të paditësit dhe të paditurit të tretë për faktin se ajo nuk punë e vlefshme juridike pasi që e njëjtë për shkak të titullarit të palajtshmërisë (e cila evidentohet në emër të personin të tretë) nuk ka mundur të legalizohet pranë Gjykatës apo tani tek Noteri, andaj një kontratë e tillë nuk paraqet punë juridike dhe e drejta është fiktive. Për këtë arsye kjo Gjykatë konsideron se apriori paditësi është dashur që të kërkoj nga shitësi që kontrata e shitblerjes të jetë eventualisht valide dhe të prodhon efekt juridik në të kundërtën paditësi po që se i shpreson suksesit në kontest, nga shitësi A. Z., në rastin konkret mund të kërkoj "restitutio in integrum" kthimin eventual të mjeteve të paguara në emër të "shitblerjes së ngastrës lëndore" me bazë juridike begatim i pa arsye.”

51. Në vijim, Gjykata e Apelit përmes Aktgjykimit [Ac. nr. 4613/2018] refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës, ndërsa në Aktgjykimin e saj theksoi si në vijim:

Gjykata e Apelit mbështet arsyetimin e vendimit të gjykatës së shkallës së parë lidhur me bartjen e të drejtës së pronësisë duke ua kujtuar palëve ndërgjyqëse nenin 36 të

LPDTS-së e cila shprehimisht përcakton "1. Për bartjen e pronësisë në paluajtshmëri është e nevojshme një punë juridike e vlefshme ndërmjet tjetërsuesit dhe fituesit si bazë juridike dhe regjistrimi i ndryshimit i pronësisë në regjistrin e të drejtave në paluajtshmëri. 2. Kontrata për bartjen e paluajtshmërisë duhet të lidhet me shkrim në prezencë të dy palëve në një zyre kompetente."

Në kuptim të dispozitave të lartcekura për bartjen e pronësisë duhet plotësuar disa kushte si a) Puna juridike (ius titulus), b) Regjistrimi i ndryshimit të pronësisë në regjistrin e të drejtave në paluajtshmëri dhe e) Puna juridike të lidhet në një zyre kompetente në prezencë të dy palëve. Parakontrata e lidhur ndërmjet palëve ndërgjyqëse këtu paditësit Isa Bacaj dhe A. Z. nuk paraqet titull juridik mbi bazën e të cilit do mund të bartej e drejta e pronësisë për arsyen se e njëjta nuk është lidhur në zyrën kompetente ashtu siç kërkohet nga ligji dhe nga fakti se bazuar në aktgjykimin e gjykatës komunale në Gjakovë i padituri A. Z. nuk ka fituar të drejtën e pronësisë, por ka fituar vetëm të drejtën e shfrytëzimit të përhershëm e që në këtë pikë qëndron edhe arsyetimi i gjykatës së shkallës së parë përkatësisht "Nemo plus iuris ad alium trans/ere quam ipse habet" askush nuk mund të tjetërsojë në tjetrin më shumë të drejta se sa që ka vetë.

52. Në fund, Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit [Rev. nr. 306/2023] refuzoi si të pathemeltë kërkesën për revizion të parashtruesit të kërkesës, ku ndër të tjera arsyetoi si në vijim:

"Kështu, sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, nga provat e administruara, nuk mund të përfundohet se paditësi është pronar i pjesës së paluajtshmërisë kontestuese, të specifikuar në dispozitiv të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, nga se me asnjë bazë juridike nuk ka provuar pronësinë në pjesën e paluajtshmërisë kontestuese, për të cilën ka kërkuar që të vërtetohet se është pronar, sikundër parashihet me dispozitën e nenit 20 të Ligjit për Marrëdhëniet Themelore Pronësore Juridike, sipas së cilës, është paraparë se e drejta e pronësisë fitohet sipas vet ligjit, në bazë të veprimit juridik (punës juridike), dhe me trashëgimi apo me vendim të organit shtetëror në mënyrën dhe nen kushtet e përcaktuara me ligj.

[...] në rastin konkret civil - juridik, paditësi nuk e ka provuar as bazën juridike e as mënyrën e fitimit (iustus titullus - modus aquirendi) të pronësisë në pjesën e paluajtshmërisë kontestuese, të sipër përmendur. Përkitazi me këtë që u sipër theksua, paditësi nuk ka provuar se e ka fituar pronësinë në kuptim të dispozitës së nenit 20 apo nenit 33 të LMTHPJ-së dhe as në bazë të parashkrimit fitues (Usucapio - neni 28 i LMTHPJ-së), përkatësisht, se me posedim dhe me mirëbesim e ka fituar pronësinë në paluajtshmërinë kontestuese.

53. Në vijim, Gjykata Supreme kishte arsyetuar edhe lidhur me pretendimin e parashtruesit të kërkesës kur i njëjti kishte pretenduar fitimin e të drejtës së pronës në bazë të parashkrimit fitues, si dhe çështjen e mosregjistrimit të parakontratës në librat e tokës, si në vijim:

"[...] edhe përkitazi me pretendimin e paditësit për fitimin e pronësisë me mbajtje, edhe kjo gjykatë, vlerëson se në këtë rast, nuk mund të bëhet fjalë për fitimin e të drejtës së pronësisë me parashkrim fitues sikundër parashihet me dispozitën e nenit 28.4 të Ligjit të sipër përmendur, sipas së cilës, përveç posedimit të sendit dhe kohëzgjatjes së posedimit prej 20 viteve, kërkohet që posedimi të jetë edhe me mirëbesim, gjë që nga arsyet e sipër theksuara, këtu nuk është rasti dhe me fjalë të tjera, në rastin konkret juridik civil nuk përmbushen konditat ligjore të përcaktuara me dispozitat e sipër përmendura ligjore. Dhe kur jemi këtu, duhet theksuar se

posedimi është me mirëbesim në qoftë se mbajtësi nuk din ose nuk mund ta dijë se sendi që e mban nuk është i tij (neni 72 i LMTHPJ-së). Në rastin konkret civil, e nga arsyet e sipër cekura, fakti relevant është se paditësi ka mundur ta dijë (edhe nga përmbajtja e para kontratës së shitblerjes së dt.15.05.2006 dhe shkresat tjera të lëndës), se pjesa e paluajtshmërisë kontestuese është e evidentuar si P.SH. "Ujërat Publike "Gjakovë. Gjithashtu, edhe me dispozitën e nenit 33 të ligjit të njëjtë, përcaktohet se në bazë të punës juridike e drejta e pronësisë në paluajtshmëri, fitohet me regjistrim në librat e tokës apo në mënyrën tjetër të caktuar me ligj, gjë që, këtu nuk ka ndodhur kështu, sikundër u theksua, sepse, para / kontrata për shitblerjen, e sipër përmendur, nuk ka qenë e vërtetuar në organin kompetent, e njëjta nuk është legalizuar dhe regjistruar në librat publik, d.m.th. nuk është lidhur në formën përkatëse ligjore, dhe si e tillë nuk është punë e vlefshme juridike si dhe nuk përmbush konditat ligjore të përcaktuara me dispozitat e sipër cekura ligjore."

54. Duke iu referuar aktgjyqimeve të gjykatave të jurisdiksionit të rregullt, Gjykata vlerëson se të njëjtat në mënyrë gjithëpërfshirëse dhe të detajuar adresuan aspektet e rastit për sa i përket refuzimit të kërkesëpadisë së parashtruesit të kërkesës, ku konkluduan se: (i) bazuar në provat e administruara nuk mund të konkludohet që parashtruesi i kërkesës është pronar i paluajtshmërisë kontestuese; (ii) i njëjti me asnjë bazë juridike nuk e provuar pronësinë në paluajtshmërinë kontestuese, siç kërkohet me dispozitat e nenit 20 dhe 33 të Ligjit për Marrëdhëniet Themelore Pronësore Juridike; (iii) parashtruesi i kërkesës nuk e ka provuar se e ka fituar pronësinë në bazë të parashkrimit fitues nga neni 28 i LMTHPJ-së, përkatësisht se me posedim dhe mirëbesim e ka fituar pronësinë mbi paluajtshmërinë kontestuese; (iv) tek çështja e parashkrimit fitues, posedimi është me mirëbesim në qoftë se mbajtësi nuk e din apo nuk mund ta dijë se paluajtshmëria që mban nuk është e tij, ndërsa në rastin konkret parashtruesi e ka ditur duke u bazuar edhe në parakontratën e shitblerjes së 15 majit 2006; (v) kontrata e shitblerjes nuk ishte e vërtetuar në organin kompetent, e njëjta nuk ishte e legalizuar dhe e regjistruar në librat publik.
55. Në kontekst të pretendimit të parashtruesit të kërkesës për arsyetim të mangët, Gjykata kujton se Gjykata dhe GJEDNJ-ja në jurisprudencën e tyre kanë theksuar se neni 31 i Kushtetutës përkatësisht neni 6, paragrafi 1 i KEDNJ-së, obligon gjykatat të japin arsyet për vendimet e tyre, ato gjithashtu kanë konstatuar se kjo nuk mund të kuptohet si kërkesë për një përgjigje të hollësishme në çdo argument. (Shih rastet e Gjykatës nr. [KI174/21](#) parashtrues *Bashkim Makiqi*, aktvendim për papranueshmëri i 16 shkurtit 2022, paragrafi 57 dhe nr. [KI97/16](#) parashtrues *IKK Classic*, aktgjykim i 4 dhjetorit 2017, paragrafi 49 dhe po ashtu shih rastet e GJEDNJ-së *Van de Hurk kundër Holandës*, nr. 16034/90, Aktgjykim i 19 prillit 1994, paragrafi 61; *Higgins dhe të tjerët kundër Francës*, nr. 134/1996/753/952, Aktgjykim i 19 shkurtit 1998, paragrafi 42).
56. Gjykata, bazuar në parimet e përgjithshme të GJEDNJ-së, siç janë elaboruar më lart dhe bazuar në arsyetimet e gjykatave të rregullta, vlerëson se në rastin e parashtruesit të kërkesës, gjykatat e rregullta kanë nxjerrë vendimet e tyre në përputhje të plotë me standardet e së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm. Kjo për faktin se nga shkresat e lëndës është e qartë se vendimmarrja ishte e bazuar në prova të ndryshme, dhe vlerësimet e ekspertëve. Rrjedhimisht, Gjykata konsideron se gjykatat e rregullta kanë përmbushur detyrimin e tyre kushtetues për të ofruar një arsyetim të mjaftueshëm ligjor përkitazi me kërkesat dhe pretendimet e parashtruesit të kërkesës. Për rrjedhojë, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës kishte përfituar nga e drejta për të pranuar vendim të arsyetuar gjyqësor, në pajtim me nenin 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.
57. Në lidhje me këtë, Gjykata e konsideron të rëndësishme të theksojë qëndrimin e përgjithshëm parimor se "drejtësia" që garantohet përmes nenit 31 të Kushtetutës, në

lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, nuk është drejtësi “*substanciale*”, por drejtësi “*procedurale*”. Në terma praktik dhe në parim, kjo drejtësi procedurale shprehet përmes procedurës kontradiktore, ku palët dëgjoen dhe vendosen në të njëjtat kushte para Gjykatës (Shih, ndër të tjera, rastin e Gjykatës, [KI131/19](#), parashtrues *Sylë Hoxha*, Aktvendim për papranueshmëri i 21 prillit 2020, paragrafi 57; dhe KI49/19, cituar më lart, paragrafi 55). Kjo më saktësisht nënkupton se palëve përgjatë një procedure të drejtë dhe të paanshme duhet: (i) t’u mundësohet zhvillimi i procedurës bazuar në parimin e kontradiktoritetit procedural; (ii) t’u ofrohet mundësia që gjatë fazave të ndryshme të procedurës të paraqesin argumente dhe dëshmi që ata i konsiderojnë të rëndësishme për rastin përkatës; (iii) t’u garantohet se të gjitha argumentet dhe dëshmitë që ishin të rëndësishme për zgjidhjen e rastit përkatës janë dëgjuar e shqyrtuar në mënyrë të rregullt nga gjykatat përkatëse; (iv) t’u garantohet se faktet dhe pretendimet ligjore në vendimet gjyqësore ishin shqyrtuar dhe arsyetuar hollësisht; dhe se, në përputhje me rrethanat e rastit, (v) t’u garantohet se procedurat, shikuar në tërësinë e tyre, ishin të drejta dhe jo arbitrare (Shih, ndër të tjera, rastin e GJEDNJ-së *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, cituar më lart, paragrafi 29; dhe rastin e Gjykatës, KI131/19, cituar më lart, paragrafi 58).

58. Gjykata arrin në përfundim se në rrethanat e rastit konkret, parashtruesja e kërkesës nuk ka argumentuar se standardet dhe garancitë e mësipërme të nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me të drejtën në vendim të arsyetuar nuk janë zbatuar. Parashtruesi i kërkesës edhe më tej mund të mos jetë i kënaqur me rezultatin e gjykimit të çështjes së tij, megjithatë, kjo pakënaqësi vetvetiu nuk mund të ngrejë një pretendim të argumentueshëm për shkeljen e të drejtave dhe lirive themelore të garantuara me Kushtetutë (shih, rastin e GJEDNJ-së: [Mezotur-Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë](#), nr. 5503/02, Aktgjykimi i 26 korrikut 2005, paragrafi 21).
59. Prandaj, Gjykata konkludon se pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së janë pretendime që kualifikohen si pretendime “*të pambështetura apo të paarsyetuara*” dhe si të tilla, këto pretendime janë qartazi të pabazuara në baza kushtetuese, siç është përcaktuar në paragrafin (2) të rregullit 34 të Rregullores së punës.

(II) Sa u përket pretendimit për shkelje të nenit 46 të Kushtetutës në lidhje me nenin 1 të Protokollit Nr. 1 të KEDNJ-së

60. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës gjithashtu thekson që vendimi i kontestuar është nxjerrë në kundërshtim me të drejtat e garantuara me nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës, si rezultat i mohimit të të drejtave pronësore të parashtruesit të kërkesës.
61. Gjykata rikujton se neni 46 i Kushtetutës, sikundër edhe neni 1 i Protokollit Nr. 1 (Mbrojtja e Pronës) i KEDNJ nuk garanton të drejtën për fitimin e pronës (Shih rastet e Gjykatës: KI201/18, me parashtrues *Selami Taraku*, Aktvendim për papranueshmëri i 1 nëntorit 2019, paragrafi 39; [KI83/18](#), me parashtrues *Ivica Milosevic*, Aktvendim për papranueshmëri i 17 tetorit 2019, paragrafi 41; Shih gjithashtu rastet e GJEDNJ-së: [Van der Mussele kundër Belgjikës](#), nr. 8919/80, Aktgjykimi i GJEDNJ-së i 23 nëntorit 1983, paragrafi 48; dhe [Slivenko dhe të tjerët kundër Letonisë](#), kërkesa nr. 73049/01, Aktgjykimi i 9 tetorit 2003, paragrafi 121).
62. Në këtë kuadër, Gjykata i referohet interpretimeve të GJEDNJ, ku vihet në pah se neni 1 i Protokollit Nr. 1 (Mbrojtja e Pronës) i KEDNJ-së vlen vetëm për “*zotërimet*” ekzistuese të një personi (shih rastet e GJEDNJ-së: [Marckx kundër Belgjikës](#), nr. 6833/74, Aktgjykim i 13 qershorit 1979, paragrafi 50; [Anheuser-Busch Inc. kundër Portugalisë](#), nr. 73049/01, Aktgjykimi i 11 janarit 2007, paragrafi 64).

63. Parashtruesi i kërkesës më tej mund të pretendojë shkelje të nenit 46 të Kushtetutës vetëm për atë që vendimet e kontestuara kanë të bëjnë me "pronën" e tij; brenda kuptimit të kësaj dispozite "pronë" mund të jetë "pasuria ekzistuese", duke përfshirë edhe pretendimet në bazë të të cilave parashtruesi i kërkesës mund të pretendojë "pritshtëri legjitime" që do të fitojnë gëzimin efektiv të ndonjë të drejte pronësore.
64. Por, sipas praktikës së GJEDNJ, nuk mund të thuhet se lind ndonjë "pritje legjitime" atje ku ekziston një kontest në lidhje me interpretimin e drejtë dhe aplikimin e së drejtës së brendshme dhe atje ku parashtruesit janë hedhur poshtë më pas nga gjykatat kombëtare (shih: [Kopecky kundër Sllovakisë](#), nr. 44912/98, Aktgjykim i 28 shtatorit 2004, paragrafi 50).
65. Mirëpo në këtë drejtim, Gjykata thekson se një pretendim kushtëzues që buron si shkak i mosplotësimit të kushtit nuk përbën "pronësi" sipas qëllimit të nenit 1 të Protokollit Nr. 1 të KEDNJ-së. Thënë ndryshe, nëse e drejta mbi diçka jetësohet vetëm nëse plotësohet një kusht specifik dhe ky kusht nuk përmbushet, atëherë ligjërisht nuk mund të posedohet mbi atë të drejtë. (shih rastet e GJEDNJ-së: [Kopecký kundër Sllovakisë](#), cituar më lart, paragrafi 35; [Prince Hans-Adam II of Liechtenstein kundër Gjermanisë](#), kërkesa nr. 42527/98, Aktgjykim i 12 korrikut 2001, paragrafi 83; [Gratzinger and Gratzingerova kundër Republikës Çeke](#), kërkesa nr. 39794/98, Vendim i 10 korrikut 2002, paragrafi 69).
66. Gjykata, duke i trajtuar pretendimet e parashtruesit të kërkesës në lidhje me parimet e lartpërmendura, vëren se parashtruesi nuk e ka arsyetuar në veçanti shkeljen e së drejtës së pronës dhe nuk i referohet konkretisht ndonjë prej parimeve të përmbajtura në nenin 46 të Kushtetutës, por konsideron se kjo e drejtë i është shkelur si pasojë e shkeljes së të drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm (nenit 31 të Kushtetutës).
67. Megjithatë, gjatë shqyrtimit të këtyre pretendimeve në kuadër të nenit 31 të Kushtetutës, Gjykata tashmë ka ardhur në përfundim se këto pretendime janë qartazi të pabazuara. Prandaj, Gjykata konsideron se në rastin konkret nuk dëshmohet se parashtruesi i kërkesës ka kërkesë të arsyetuar lidhur me shkeljen e të drejtës së pronës sipas nenit 46 të Kushtetutës.
68. Prandaj, kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, prandaj deklarohet e papranueshme, në pajtim me rregullin 34 paragrafi (2) të Rregullores së punës.

(III) Pretendimet e parashtruesve të kërkesës lidhur me shkeljen e nenit 24 të Kushtetutës

69. Në vijim, Gjykata rikujton që parashtruesi i kërkesës gjithashtu pretendon se gjykata e shkallës së parë, në një çështje relativisht të ngjashme ka vendosur ndryshe, ku "qytetarit në atë rast i janë mbrojtur të drejtat njerëzore dhe liritë themelore". Rrjedhimisht, i njëjti thekson se "këta shembuj i janë bashkëlidhur ankesës ndaj aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë", por i njëjti nuk i shtjelluar para Gjykatës. Prandaj, këto pretendime i cilëson se përkojnë me aplikim në mënyra të ndryshme të ligjit për qytetarë të ndryshëm, prandaj kemi shkelje të parimit të barazisë para ligjit, e cila e drejtë është e garantuar me nenin 24 të Kushtetutës.
70. Sa i përket shkeljeve të pretenduara të të drejtave dhe lirive themelore të përcaktuara me nenin 24 të Kushtetutës, Gjykata rikujton se sipas praktikës gjyqësore të kësaj Gjykate dhe të GJEDNJ-së, Gjykata e shpall kërkesën të papranueshme si qartazi të pabazuar kur pretendimet janë "të pambështetura apo të paarsyetuara" ose kur plotësohet një nga dy kushtet karakteristike, përkatësisht;

- a) kur parashtruesi i kërkesës thjesht citon një ose disa dispozita të Konventës apo të Kushtetutës, pa shpjeguar mënyrën se si ato janë shkelur, përveç nëse kjo është qartazi e dukshme në bazë të fakteve dhe rrethanave të rastit (shih: në këtë drejtim, rastet e GJEDNJ-së: [Trofimchuk kundër Ukrainës](#), nr. 4241/03, Vendim i 31 majit 2005; dhe [Baillard kundër Francës](#), nr. 6032/04, Vendim i 25 shtatorit 2008);
- b) kur parashtruesi i kërkesës nuk paraqet ose refuzon të paraqesë provat materiale me të cilat do t'i mbështeste pretendimet e tij (kjo posaçërisht vlen për vendimet e gjykatave ose të autoriteteve të tjera të brendshme), përveç rasteve kur ekzistojnë rrethana të jashtëzakonshme që janë jashtë kontrollit të tij dhe të cilat e pengojnë ta bëjë këtë (për shembull, kur administrata e burgut refuzon t'ia paraqesë Gjykatës dokumentet nga dosja e një të burgosuri për të cilin bëhet fjalë) ose nëse Gjykata vet nuk vendos ndryshe (shih rastin e Gjykatës: [KI166/20](#), me parashtrues, *Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale*, Aktvendim për papranueshmëri i 5 janarit 2021, paragrafi 42).
71. Në rastin konkret, parashtruesi i kërkesës pretendon që vendimi i kontestuar ka shkelur të drejtat individuale dhe ka ardhur deri te shkelja e nenit 24 të Kushtetutës, mirëpo nuk shpjegon specifikisht se si ka ardhur deri te shkelja e këtij neni. Lidhur me këtë, Gjykata rikujton se ajo ka theksuar vazhdimisht se vetëm referimi dhe përmendja e neneve të Kushtetutës dhe të KEDNJ-së nuk është e mjaftueshme për të ndërtuar një pretendim të argumentuar për shkelje kushtetuese. Kur pretendohen shkelje të tilla të Kushtetutës, parashtruesit e kërkesës duhet të sigurojnë pretendime të arsyetuara dhe argumente bindëse (shih rastet e Gjykatës: [KI175/20](#), me parashtrues: *Agjencia Kosovare e Privatizimit*, Aktvendim për Papranueshmëri i 22 prillit 2021, paragrafi 81; [KI166/20](#) cituar më lart, paragrafi 52; [KI04/21](#), me parashtruese *Nexhmije Makolli*, Aktvendim për papranueshmëri i 11 majit 2021, paragrafët 38- 39).
72. Andaj, Gjykata konstaton se sa i përket pretendimit të parashtruesit të kërkesës për shkelje të nenit 24 të Kushtetutës, kërkesa duhet të deklarohet e papranueshme si qartazi e pabazuar, sepse ky pretendim cilësohet si pretendim që i takon kategorisë së pretendimeve “*të pambështetura ose të paarsyetuara*”, pasi parashtruesi i kërkesës thjesht ka cituar një dispozitë të Kushtetutës, pa shpjeguar se si është shkelur ajo. Prandaj, ky pretendim është qartazi i pabazuar në baza kushtetuese, siç përcaktohet në paragrafin (2) të rregullit 34 të Rregullores së punës.

Përfundim

73. Në fund, Gjykata konstaton se kërkesa e parashtruesit të kërkesës është e papranueshme, sepse (I) pretendimet për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës, për sa i përket vendimit të paarsyetuar gjyqësor kualifikohen si pretendime qartazi të pabazuara në baza kushtetuese; (II) pretendimet për shkelje të nenit 46 të Kushtetutës, janë pretendime që kualifikohen si pretendime qartazi të pabazuara në baza kushtetuese, si dhe (ii) përkitazi me pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkelje të nenit 24 të Kushtetutës, deklarohen si qartazi të pabazuara, sepse këto pretendime cilësohen si pretendime që i takojnë kategorisë së pretendimeve “*të pambështetura ose të paarsyetuara*”. Prandaj, kërkesa në tërësi deklarohet e papranueshme si qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, siç përcaktohet në paragrafin (2) të rregullit 34 të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 të Kushtetutës, nenit 20 të Ligjit dhe në pajtim me rregullin 34 (2) dhe 48 (1) (b) të Rregullores së punës, më 16 korrik 2024, njëzëri:

VENDOS


- I. TË DEKLAROJË, kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË, këtë Aktvendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË, këtë Aktvendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me paragrafin 4 të nenit 20 të Ligjit;
- IV. Ky Aktvendim hyn në fuqi në ditën e shpalljes në Gazetën Zyrtare, në pajtim me paragrafin 5 të nenit 20 të Ligjit.

Gjyqtari raportues


Radomir Laban

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese




Greša Caka-Nimani